

Titulli i lëndës: Gjeometri Deskriptive

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë
Titulli i lëndës:	GJEOMETRI DESKRIPTIVE
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	prof. asoc. dr. Arta Basha-Jakupi
Të dhënat kontaktuese:	Email: arta.jakupi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	
	<p>Ky kurs është një hyrje intensive për disipinat gjeometrike ne arkitekture që ndikojnë në reciprocitetin midis vizatimit dhe modelimit në procesin e dizajnit arkitekturor, të mësuar kryesisht nëpërmjet një sere ushtrimesh javore ose dy javore. Qëllimi pedagogjik i kursit është dyfishtë, ai teorik dhe grafik. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimëve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e gjeometrisë deskriptive dhe perspektives gjeometrike dhe më pas, pasi fitojnë konceptet kryesore do trajtohen, në kuadër të projekteve arkitektonike/konstruktive.</p> <p>Baza konceptuale e çdo ushtrimi janë parimet gjeometrike që qëndrojnë në thelbin e secilës teknikë, duke 'përgjithësuar' teknikën specifike për të treguar për mundësitë e saj gjeneruese ne kontekste më të gjera.</p>
Qëllimet e lëndës:	
	Përgatitja bazike për prezantimin profesional dhe teknik të formave tredimensionale, përkatësisht projekteve arkitektonike si dhe zhvillimin e aftësive për kuptimin e hapësirës tredimensionale dhe të menduarit hapësinor në kontekst të artikullimit të nocioneve themelore në profesionin e ndërtimtarisë
Rezultatet e pritshme të nxënies:	
	<p>Të sigurojë studentëve përmbajtjen kryesore të gjeometrisë përshkruese dhe zbatimin e saj, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të përkthejnë modelet gjeometrike të tre dimensioneve të arkitekturës në përfaqësime normativisht korrekte.</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jetë në gjendje të kryejë një lidhje dyanësh mes realitetit dhe modelit të saj të matshëm grafik. Kjo njohuri është thelbësore për të kuptuar hapësirën dhe përfaqësimin e saj në mbështetjen dy dimensionale. Nxënësi gjithashtu do të posedojë njohuritë bazë për të zotëruar të gjitha mjetet e vizatimit. - aplikimi i metodave të ndryshme të përfaqësimit, të bëra nga studimi i gjeometrisë përshkruese dhe praktika e hartimit manual, do t'i lejojë nxënësit të zhvillojë gjuhën e vet grafike dhe shprehjen e tij në fushën specifike të arkitekturës.

	- zhvillimin e aftësive për kuptimin e hapësirës dy dimensionale dhe tredimensionale dhe të menduarit hapësinor.		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike	1	15	30
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	15		15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Metoda e të mësuarit të lëndës së Gjeometrisë Deskriptive konsiston në mbajtje të ligjëratave dhe mbajtje të ushtrimeve për njësi të veçanta mësimore të përjavshme, pastaj në punimin e grafikoneve dhe modeleve – maketave për njësi të caktuara mësimore.		
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë dhe shtëpi 30%; Vlerësimi nga testet 60%; Provimi final 60% nëse nuk e kane kaluar me teste.		
Literatura primare:	The Projective Cast: Architecture and Its Three Geometries. MIT Press, 2000 Ching, F., & Steven P. J., (2010) Design Drawing. 2nd ed. Wiley Cohen, P. S., (2001) Contested Symmetries and Other Predicaments in Architecture. Princeton Architectural Press		
Literatura shtesë:	Pottmann, H, Andreas A.,(2007) et al. Architectural Geometry. Bentley Institute Press. G.R. Bertoline, E.W. Wiebe, C.L. Miller, L.O. Nasman, (1995) Engineering Graphics Communication. R.D. Irwin Inc., Chicago, Chapter 11, pp. 597–695. Flamur DOLI,1990, Gjeometria Deskriptive		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1:	Hyrje. Metodat e projektimit. Projeksioni i pikës në një rrafsh. Projeksioni i pikës në dy rrafshë – KUADRANTET. Projeksioni i pikës në kuadrantet përkatëse.		

Java 2:	Projeksioni i pikës në tri rrafshet – OKTANTET. Projeksioni i pikës në oktantet përkatëse.
Java 3:	Projeksioni i pikës në tri rrafshet – OKTANTET. Projeksioni i pikës në oktantet përkatëse.
Java 4:	Projeksionet e drejtëzës me pozitë të çfarëdoshme. Projeksionet e drejtëzës me pozitë të veçantë.
Java 5:	Ndërprerja e drejtëzës me rrafshet e projektimit - gjurmët e drejtëzës.
Java 6:	Projeksionet e rrafshit me pozitë të çfarëdoshme. Projeksionet e rrafshit me pozitë të veçantë. Projeksionet e rrafsheve projektuese.
Java 7:	Projeksionet e rrafshit në të cilin shtrihen drejtëza me pikë. Projeksionet e rrafshit në të cilin shtrihen drejtëzat me pozitë të veçantë. Paralelet e rrafshit. Horizontalja e rrafshit. Ballorja e rrafshit. Anësorja e rrafshit.
Java 8:	Projeksionet e rrafshit të dhënë me trekëndësh. Përdorimi i paraleles së parë dhe të dytë.
Java 9:	Projeksionet e rrafshit të dhënë me dy drejtëza të cilat ndërpriten. Projeksionet e rrafshit të dhënë me dy drejtëza paralele.
Java 10:	Projeksioni i ndërprerjes së dy rrafsheve. Ndërprerja e drejtëzës me rrafsh të çfarëdoshëm.
Java 11:	Transformimi – ndërrimi i rrafsheve të projektimit. Transformimi i pikës. Transformimi i drejtëzës. Transformimi i trekëndëshit.
Java 12:	Rrotullimi. Rrotullimi i pikës. Rrotullimi i trajtës gjeometrike. Përcaktimi i madhësisë së vërtetë të drejtëzës, si dhe i këndeve të cilat i formon drejtëza me rrafshet e projektimit.
Java 13:	Metoda e përputhjes – rrëzimit të rrafshit të çfarëdoshëm dhe projektues.
Java 14:	Ndërprerja e trupave poliedrik. Ndërprerja e piramidës me rrafsh projektues. Ndërprerja e piramidës me rrafsh të çfarëdoshëm. Hartimi i mbështjellësit të piramidës.
Java 15:	Ndërprerja e piramidës me plane arbitrare. Shpalosja e anvelopes së piramidës.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimt duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.